



**PËR TË MOS HARRUAR  
SE KUSH JEMI..!**



**RAMAZANI, MUAJI I  
BASHKËSISË MUSLIMANE**



**RAMAZANI,  
MUAJI I KUR'ANIT**

Viti 17 - Nr. 5 (195),  
Maj, 2019  
Botim i Myftinisë Shkodër

# UDHA ISLAME

*E përmuajshme  
Informative - Fetare  
Kulturore - Edukative*

## Muaji Ramazan, mundësi për t' u afruar përherë e më shumë me All-llahun e Madhëruar



"Të bëhemi shkak që ky Islam të lulëzojë e të gjallërojë përherë e më shumë në tokën tonë, që e kemi të shtrenjtë, si dritën e syve, që punojmë për të ditë-natë, që e duam dhe lutemi për të, që duam bashkëqytetarët tanë dhe lutemi e punojmë për paqen sociale për harmoninë komunitare dhe lartësimin e vlerave tona më të mira kombëtare, që përkunden në djepin e besimit dhe fesë."

### “KARTA E MEKËS”, KONFERENCA HISTORIKE E LIGËS BOTËRORE ISLAME

**N**ën kujdesin e Mbretit Selman bin Abdulaziz të Arabisë Saudite, në datat 27-30 maj 2019, Liga Botërore Islame zhvilloi në Mekë konferencën ndërkombëtare me temë: “Vlerat e qëndrimit të moderuar dhe mesatar në tekstet e Librit dhe të Traditës”, ku morën pjesë mbi 1200 myftilerë, studiues islamë, mendimtarë e drejtues të organizatave ndërkombëtare islame, nga 139 shtete të botës.





**Imam Muhamed Sytari**  
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, Zotit të vetëm të gjithësisë, i Cili urdhëron në Kur'anin Famëlartë: "Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju..."<sup>1</sup>

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë në këtë ditë dhe në çdo moment të jetës tonë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhamedit (a.s.), i cili i jepte sihariq sahabëve të tij me rastin e ardhjes së Ramazanit, teksa i drejtohej me këto fjalë: "Ju erdhi Muaji Ramazan, një Muaj i begatë! All-llahu jua ka obliguar agjërimin e tij! Në të hapen dyert e xhennetit, në të mbyllen dyert e skëterrës, në të prangosen shejtanët! Në të gjendet një natë, më e mirë se një mijë muaj! Ai që është privuar nga e mira e këtij Muaji, është privuar!"<sup>2</sup>

### TË DASHUR BESIMTARË,

Resulull-llahu (a.s.) na ka edukuar se: "Agjërimi është mburojë, prandaj mos të abuzojë njeri, as mos të bjerë në injorancë! Edhe nëse dikush e sulmon a e shan, le t'i thotë: Unë jam agjërueshëm (dy herë)! Pasha Atë, që e ka shpirtin tim në dorën e tij, shija e gojës së agjëruetit, është më e mirë tek All-llahu se aroma e miskut! (Ai thotë) E lë ushqimin e tij, pijen e tij, epshin e tij, për hatrin Tim! Agjërimi është i Imi, Unë e jap shpërblimin për të, ndërsa e

1. Kur'ani, El-Bekare: 185.  
2. Transmetuar nga Imam Ahmedi, Nesaiu, nga Ebu Hurejra (r.a.).

## "UNË JAM AGJËRUESHËM! UNË JAM AGJËRUESHËM!"

mira shpërblehet me dhjetëfishin e saj!"<sup>3</sup>

Poashtu na ka mësuar se: "Ai që e agjëron Ramazanin me besim dhe bindje, do t'i falen gjynahet e tij të shkuara!"<sup>4</sup> Që do të thotë se të gjithë jemi të ftuar të hyjmë në një atmosferë të lartë besimi dhe shpërblimesh, që nuk ka të ngjashme gjatë gjithë vitit!

Prandaj, të bëhemi gati e të angazhohemi maksimalisht, që ky Muaj të na kalojë në adhurime e bamirësi, në namaze e lutje, në lexim të Kur'anit e në veshje me moralin e tij, në mënyrë, që kjo natyrë besimi dhe adhurimi të vazhdojë ndër ne derisa të jemi në këtë botë!

Poashtu na mëson se: "Ai që e kalon natën e Ramazanit me adhurim, me besim dhe bindje, do t'i falen gjynahet e tij të shkuara!"<sup>5</sup>

**"AGJËRIMI ËSHTË MBURJË, PRANDAJ MOS TË ABUZOJË NJERI, AS MOS TË BJERË NË INJORANCË! EDHE NËSE DIKUSH E SULMON A E SHAN, LE T'I THOTË: UNË JAM AGJËRUESHËM (DY HERË)! PASHA ATË, QË E KA SHPIRTIN TIM NË DORËN E TIJ, SHIJA E GOJËS SË AGJËRUESIT, ËSHTË MË E MIRË TEK ALL-LLAHU SE AROMA E MISKUT! (AI THOTË) E LË USHQIMIN E TIJ, PIJEN E TIJ, EPSHIN E TIJ, PËR HATRIN TIM! AGJËRIMI ËSHTË I IMI, UNË E JAP SHPËRBLIMIN PËR TË, NDËRSA E MIRA SHPËRBLEHET ME DHJETËFISHIN E SAJ!"**

Pra, na janë dhënë dy mundësi të mëdha për faljen e gjynaheve; agjërimi ditën dhe namazi i teravisë natën! Prandaj, të bëhemi gati, të pastrojmë zemrat me istigfar, të rregullojmë besëlidhjen me All-llahun e Madhëruar, të lahemi e të pastrohemi, të rregullojmë shtëpitë e të përgëzojmë fëmijët, të përhapim kudo lajmin e mirë të mbërritjes së Muajit të Madh të mëshirës dhe të faljes!

Ky është Muaji i ndreqjes së realiteteve, i përmirësimit të gjendjes, i kapërcimit të vështirësive dhe i pastrimit të zemrave, deri në atë gradë, sa që Resulull-llahu (a.s.) na ka dhënë sihariqin e madh se: "All-llahu liron nga ndëshkimi i tij,

3. Transmetuar nga Imam Bukhariu, nga Ebu Hurejra (r.a.).  
4. Transmetuar nga Imam Bukhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a.).  
5. Transmetuar nga Imam Bukhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a.).

për çdo natë, në momentin e iftarit!"<sup>6</sup>, sikurse thotë: "All-llahu i Madhëruar liron nga ndëshkimi i Tij, çdo ditë e çdo natë (të Ramazanit) dhe çdo musliman, çdo ditë e çdo natë (të Ramazanit) e ka një lutje të pranuar!"<sup>7</sup>

### TË DASHUR BESIMTARË,

Duhet të dimë se agjërimi i Ramazanit është shkak për faljen e gjynaheve, që nga Ramazani i shkuar, nëse distancohemi nga gjynahet e mëdha! Resulull-llahu (a.s.) na jep sihariq duke thënë: "Namazi në namaz, e xhumaja në të xhuma dhe Ramazani në Ramazan, janë shkak për faljen e gjynaheve, nëse distancohet nga gjynahet e mëdha!"<sup>8</sup>

Poashtu, namazi i natës së këtij Muaj ka një vlerë të madhe, të

paimagjinueshme për ne, deri në atë gradë, sa Resulull-llahu (a.s.) na dëshmon se: "Ai që falet natën me imamin, derisa ai të largohet, do t'i shkruhet shpërblimi i krejt asaj nate!"<sup>9</sup> Prandaj, ejani së bashku ta gjallërojmë xhaminë në namazin e teravisë dhe të mos lëmë asnjë rekat prej rekateve të saj pa e falur, si dhe të largohemi bashkë me imamin e xhamisë, të gjithë së bashku, që ta fitojmë këtë shpërblim të madh e të pallogaritur! Sepse, sikurse na kanë mësuar komentuesit e hadithit, ndër ta edhe Imam Neveviu, qëllimi i namazit të natës në Ramazan është namazi i teravisë.

6. Transmetuar nga Imam Ahmedi, nga Ebu Umame (r.a.).  
7. Transmetuar nga Bezzari, nga Ebu Umame (r.a.).  
8. Transmetuar nga Imam Muslimi.  
9. Transmetuar nga Ebu Davudi, nga Ebu Dherri (r.a.).

Poashtu Umreja në Ramazan, ka një shpërblim të jashtëzakonshëm dhe vlen sa një haxh! Resulull-llahu (a.s.) i tha një gruajë ensarite: "Çfarë të ndaloj të bëje Haxhin me ne?" ... Pas përgjigjes së saj, i tha: "Kur të vijë Ramazani bëje Umren, sepse një Umre në të vlen sa një Haxh!"<sup>10</sup>

Dhe sot, falë All-llahut, janë mundësuar shumë rrugë drejt realizimit të kësaj porositë të madhe, me kushte të favorshme e me lehtësime, si asnjëherë më parë, prandaj, kushdo që e ka mundësinë, mos ta neglizhojë këtë ftesë, të shkojë në vendet e shenjta, të agjërojë e të bëjë tavaf, të lutet e të japë iftar, duke shijuar bekimet e All-llahut dhe mirësitë e Tij!

Poashtu në Ramazan është shumë e pëlqyer të lexohet Kur'ani e të qarkullojnë hallkat e tij nëpër xhami e shtëpi, sepse sikurse është transmetuar në hadithet e sakta: "Xhibrili e takonte Resulull-llahun (a.s.) në çdo natë Ramazani, duke e përsëritur Kur'anin."<sup>11</sup> Nga këtu, dijetarët tanë na kanë nxitur që të mos ndahemi nga Kur'ani gjatë Ramazanit. Edhe në Shkodër e kemi traditë shekullore tubimin për Hatmen e Kur'anit, që do të nisë edhe sivjet me mbarësinë e All-llahut, në xhaminë e Parrucës, çdo ditë pas namazit të iqindisë. Ju ftoj me zemër të bëhemi pjesë masivisht në këtë tubim të begatë e të mbushur me mirësi e paqe!

### VËLLEZËR E MOTRA,

Elhamdulillah na erdhi kjo ditë dhe këto mundësi për të agjëruar e për t'u falur në kushte të lira, ndërkohë që në mesin tonë e prej të shkuarve tanë, ka pasur shumë e shumë që janë sprovuar edhe me lirinë dhe persekutimin më të pakuptimtë të historisë së njerëzimit, duke iu prishur agjërimi, duke iu ndaluar, duke u kërcënuar për praktikimin e fesë, njësoj siç ndodh sot me muslimanët e disa vendeve të Azisë së largët!

Para jush do të sjell një dëshmi të një njeriu, që e kemi njohur dhe e kemi dashur, atë të Myftiut të Shkodrës, H. Faik Hoxha, i cili e burgosur me 25 vite,

10. Transmetuar nga Imam Bukhariu dhe Muslimi, nga Ibn Abbasi (r.a.).

11. Transmetuar nga Imam Bukhariu dhe Muslimi.



prej të cilave 23 i kaloi burgjeve.

Në monografinë time mbi jetën e tij, kam sjellë edhe këto dëshmi, që ia kam marrë personalisht dhe gjenden edhe të regjistruara me zërin e tij, ku thotë: "Fillimisht, duhet të përmend se gjatë gjithë kohës në burg, jam munduar që obligimet fetare t'i kryej me rregull dhe të mos shkëputem nga adhurimi i Zotit! Kam falur namazin i ulur, kuptohet, pasi në formë normale ishte e pamundur. Disa shokë të mi e dinin këtë, por asnjëherë nuk folën. Asokohe jam bërë edhe inspirues për shumë të burgosur për të mos humbur besimin në Zotin dhe për t'iu drejtuar Atij! Disave u kam mësuar edhe salavate mbi pejgamberin (a.s.), lutje të ndryshme etj.

Kujtoj një shok burgu, i cili kishte dëshirë të mësonte suren "Jasin". Ai kishte një bllok, ku e kishte shkruar këtë sure me shkronja shqipe dhe njëkohësisht kishte shkruar edhe fjalë në anglisht, italisht etj, në mënyrë që të mos diktohej.

Kur vinin Netët e Mëdha, Ramazani, Bajrami etj, i kujtoja edhe të tjerëve për të agjëru, për të falë ndonjë namaz.

Kujtoj një rast tjetër. Ishte Ramazan. I kisha porositur familjarët të më sillnin një lugë druri. Atje kisha një bidon alumini, ku përgatisja përsesh me çaj, të cilin e konsumoja në kohën e syfyrit, i shtrirë, për të mos u diktuar! Ndërsa, kur vinte koha e iftarit, sidomos në ato vite kur koha e tij vinte pas vaktit të darkës, merrja një plasmas, bukën e ndaja kafshatë-kafshatë. Në atë kohë na nxirrnin për të parë lajmet e orës 20.00 dhe aty, nxirrja nga një kafshatë buke dhe me të bëja iftar! Ndërsa në mensë, ndërroim tasat me ndonjë prej shokëve dhe unë ngrihesha për ta larë tasin e tij bosh, duke dhënë për të kuptuar se kisha ngrënë!

Kujtoj në një prej mbledhjeve të burgut, një prej komisarëve, që shpesh na spiunonte, ngrihet për të bërë analizën e brigadës se kush punonte dhe kush jo. Aty, përpara kryetarit të këshillit të riedukimit, ai përmend se në mesin tonë kemi një rast, një të burgosur, që megjithëse punon mirë dhe sillet mirë, ai agjëron dhe është fetar. Ai, i nervozuar

pyet se kush është ky person. Për fat të mirë, meqenëse ne kishim të drejtë të rruheshim vetëm një herë në javë dhe për shkak të mundimeve të burgut, i nxirë nga dielli, i pa krehur ngrihem në këmbë. Asokohe isha rreth të pesëdhjetave. Ai, duke më pandehur si shumë të moshuar, me një lloj ironie i drejtohet: "Ky është?! Këtë lëreni, se edhe një vit, dy, nuk ka për të agjëru më shumë, por ju kujdesuni për këta të rinjtë!" Më ruajti Zoti dhe ma ktheu të keqen e tij në të mirë, pasi nga ai vit, unë nuk fshihesha më për të ngrënë iftar, por haja haptas, pa shqetësuar njeri!

Prej shokëve të mi të burgut, që agjëronin gjithashtu ishte edhe Hamza Cungu, një burrë nga Ura e Shtrenjtë, që e quanin Isa, një hoxhë nga Kamica etj. Pra, ishim katër-pesë vetë që e mbanim agjërimin e Ramazanit.

Ndërsa kur vinte koha dhe mundësia për faljen e namazit, shpesh merrja ndonjë libër dhe e vendosja para syve, sikur po lexoja. Ndërsa jacinë e falja vonë. Sabahun e falja para se të bëhej zgjimi i të burgosurve. Madje, një herë, një prej rojeve (kujtoj se ishte prej Mallakastre) që më kishte parë shpesh herë të ngrihesha para të tjerëve, vjen në dhomë dhe më gjen duke larë këmbët. Ftohtë ishte. Bënte dimër. Më pyeti me habi: "Përse i lan këmbët?" Ia ktheva: "Jam me reumatizëm, këmbët më ftohen, prandaj i laj me ujë të ftohtë që të më ngrohen sadopak!"<sup>12</sup>

### TË DASHUR TË PRANISHËM,

Agjërimi i Ramazanit është një mundësi e madhe për të ndryshuar për mirë, për të parë ndrysh jetën, për të vështruar ndrysh argumentet e Tij përreth nesh, për t'u thelluar në atë që lexojmë nga Fjala e Tij, për ta thyer rutinën e nefsit dhe për t'i dëshmuar Zotit se, në përpjekje drejt Tij, ne mund të ndryshojmë, për t'u lartësuar në gradët e "nefsit të rehatuar" me Zotin e me bekimet e Tij!

(Hytbeja e mbajtur në xhaminë e Parrucës, më 3 maj 2019, në prag të fillimit të Muajit Ramazan 1440)

12. Muhamed Sytari, Faik Hoxha, para pasqyrës së një jete..., LOGOS-A, Shkup, 2011, f. 29-32.



## MESAZH DREJTUAR IMAMËVE NË PRAG TË RAMAZANIT 1440/2019

### TË NDERUAR PRIJËS TË MUSLIMANËVE,

**E** falënderojmë All-llahun e Madhëruar që na dha mundësi të jemi në shërbim të Fjalës dhe fesë së Tij, në gjurmët e Më të Mirit të Krijësive të Tij, Hz. Muhammedit (a.s.) dhe dijetarëve të këtij ymeti, nga ajo kohë, deri në kiamet.

Atij i takon falënderimi i plotë, për shpalljen hyjnore: "Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit." – (Kur'ani, Ali Imran: 104)

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë Zotërisë së bijve të Ademit, Resulull-llahut tonë (a.s.), i cili na dëshmoi se është dërguar Mësues dhe Mëshirë e dhuruar!

Në prag të Muajit Ramazan 1440, ju drejtohem më këtë mesazh udhëzues, duke u lutur që gjithsecili prej nesh të ketë mbarësi dhe sukses në misionin fisnik të shërbimit dhe udhëzimit të shoqërisë drejt asaj që është më e mira në këtë Muaj e deri sa Krijuesi të marrë amanetin e Tij në jetën e përtejme!

### TË DASHUR VËLLEZËR TË SHTRENJTË,

Muaji Ramazan vjen për të na afruar përherë e më shumë me All-llahun e Madhëruar, Zotin e vetëm të gjithësisë, me Kur'anin Famëlartë, me Traditat e Hz. Muhammedit (a.s.) dhe me vlerat më të larta të kësaj feje të pastër islame.

Prandaj, këshilloj veten dhe gjithsecilin prej jush, që ta kemi frikë All-llahun në këto ditë, të punojmë fort për lartësimin e Mesazhit dhe përhapjen e tij, si dhe të bëhemi nxitës dhe promovues të harmonisë dhe bashkimit, vëllazërisë dhe bashkëpunimit në mesin e muslimanëve dhe shoqërisë tonë.

### VËLLEZËRIT E MI IMAMË DHE THIRRËS ISLAMË,

Ky Muaj vjen si mundësi e madhe për t'i afruar edhe më shumë muslimanët me xhaminë, me mexhliset e dijes, me tubimet e dhikrit, me mbledhjet e leximit të Kur'anit, me nxitjen e bamirësisë, me lidhjen e familjes rreth sofrave të begata të besimit, me rregullimin e marrëdhënieve fafaisnore dhe përhapjen e paqes së zemrës me

këdo e kudo, duke u dëshmuar si faktorë të sigurisë, harmonisë e paqes sociale!

Kemi nevojë sot, të largojmë vëmendjen e njerëzve nga detajet e përçarjes dhe divergjencës, duke mos lejuar hapjen e debateve, që dikush i mbolli në këtë ymet, për të ngelur përherë në dyshim e për të vuajtur bashkësia e muslimanëve largimin e zemrave nga njëra-tjetra!

Mos të merremi me detaje, për të cilat nuk jemi ngarkuar dhe falë Zotit, njerëzit e kanë ruajtur udhëzimin drejt All-llahut nëpërmjet tyre për shekuj! Mos të angazhohet njerëzit me detaje që jua ngushtojnë fenë, ia ndërlikojnë atë, i lënë në mëdyshje!



Kemi nevojë që ato tradita të bukura të Muajit Ramazan, t'i shfrytëzojmë për të thelluar përherë e më shumë besimtarët në kuptimet dhe shpirtin e fesë, larg fanatizmave të verbra, larg bidateve të reja, larg abuzimit me lexime egoiste të teksteve dhe nxitje të ndasive në mesin e familjes tonë të madhe islame!

### TË DASHUR MBROJTËS TË AMANETEVE TË RESULLULL-LLAHUT (A.S.),

Do të pyetemi një ditë për këto mundësi që na janë dhënë dhe shfrytëzimin e tyre, për kohën, për dijen, për xhematet, për hapësirat e zhvillimit të Thirrjes Islame, për fjalën e thënë, për qëndrimet dhe për çdo detaj që lidhet me mirëfunksionimin e krejt shërbimeve tona në hak të Fesë së All-llahut!

Prandaj, të punojmë bashkërisht, dorë për dorë, të ndreqim atë që është prishur në këto 29 vite, të korrigjojmë

rrëshqitjet e kësaj kohe, të mbledhim familjen dhe të shfaqim gëzimin dhe madhëstini të këtij Muaji, nëpërmjet ruajtjes së harmonisë, identitetit dhe veçorive të mrekullueshme të besimit tonë!

Të punojmë pa asnjë hezitim, duke kaluar kufijtë e lodhjes, rutinën dhe krejt pengesat në rrugën tonë, për të mbjellur mirësi e bashkim, për të ruajtur ekuilibrat, për të edukuar brezin e ri me këtë Islam të bekuar, me të cilin All-llahu i nxori katragjyshërit tanë dhe brezat e shekujve të largët, deri në ditët tona, nga errësira në dritë!

Të bëhemi shkak që ky Islam të lulëzojë e të gjallërojë përherë e më shumë në tokën tonë, që e kemi të shtrenjtë, si dritën e syve, që punojmë për të ditë-natë, që e duam dhe lutemi për të, që duam bashkëqytetarët tanë dhe lutemi e punojmë për paqen sociale për harmoninë komunitare dhe lartësimin e vlerave tona më të mira kombëtare, që përkunden në djepin e besimit dhe fesë.

T'i afrojmë njerëzit me Zotin e tyre, nëpërmjet agjërimin dhe mos ta bëjmë agjërimin pengesë e rrugë të mbyllur drejt All-llahut të Madhëruar, me fjalë të pamatura, me fetva të pakontrolluara e me mungesë urtësie në komunikim me njerëzit!

Traditat tona islame të bazuara në Kur'an, në Traditat e Pejgamberit (a.s.) dhe në urtësinë e Prijësve tanë, janë të mjaftueshme që të mos kërkojmë prishjen e tyre, duke nxitur anarshi e pasiguri në mesin e besimtarëve!

Të mjaftohemi me atë që është trashëguar, ta zhvillojmë e ta ruajmë si dritën e syrit dhe t'i lutemi Zotit të gjithësisë që të na bëjë çelësa të së mirës, drynj të së keqes, fitnes dhe përçarjes!

All-llahu ju dhashtë mbarësi dhe e begatoftë kohën tuaj, mundin dhe sakrificën për hatrin e Tij, e shumëfishoftë shpërblimin tuaj dhe ju dhashtë atë që ju gëzon në këtë jetë dhe në të përtejmen!

*Vel-hamdu lil-lahi Rabil-alemin!*

Myftiu i Juaj

**Imam Muhamed B. Sytari**

*Myfti i Zonës Shkodër*

*Shkodër, më 2 maj 2019*

**K**ohë më parë, i nderuari H. Fejzi Zaganjori, më pat kërkuar që në xhaminë e Rusit, të organizojmë një ceremoni në përkujtim të burrit të urtë, Mësuesit të heshtur të alfabetit të Kur'anit dhe leximit të tij, Haxhi Hilmi Hoxha, i cili u nda nga jeta më 3 maj 2015 dhe të xhumanë e kaluar u përkujtua me një dua-hatme në xhaminë e tij, ashtu si i takon të përkujtohen të dashurit që na mungojnë...

Pas asaj bisede me vlerë, u përfshiva nga dy ndjesi në vetvete, për të cilat nuk fola me bashkëbiseduesin tim, ndonëse doja të flisja...

Ndjesia e parë ishte ajo e dhimbjes për largimin nga jeta, njëri pas tjetrit, të burrave të moshuar, besimtarëve qytetarë shkodranë, që ishin protagonistë të frekuentimit të aktiviteteve islame në qytetin e Shkodrës, që në ditët e para të rimëkëmbjes, pas inkuizionit komunist ndaj Islamit dhe muslimanëve në vendin tonë. (Një ndër ta ishte edhe i nderuari, Haxhi Hilmi Hoxha)

Natyrshëm, unë që i shkruaj këto rreshta, asokohe isha rreth të 15-ve dhe ndiqja me vëmendje lëvizjet e më të moshuarve, (duke nisur nga Gjyshi im, rahmet pastë), shihja përkushtimin e tyre, dëgjoja në heshtjen e nxënësit, bisedat e tyre me thelb fetar, tregimet plot pathos, historitë me pejgamberë e eulija, por jo vetëm...

Herë në bahçen e Gjyshit, herë në odën e tij, herë në faltoren e parë te shtëpia e Bajajve, më pas në Parrucë, pak më pak te xhamia e Plumbit a te ajo e Kirasit e në vazhdim...

Më kujtohen ca burra të vjetër, besimtarë në përkushtim, si: Zotni Fadili, (nuk më kujtohet mbiemri i tij, që ndoshta, kurrë se kam ditur se si e kishte), një burrë i hajthëm, gjatosh e me një karizëm karakteristike shkodrane, që shpesh, kur ngrihesha në këmbë për të kënduar ezanin në faltoren e Parrucës, teksa më jepte zemër dhe përpiquej të më largonte emocionet e rastit, më drejtohej: "Kndo Sulltan, mos ki gajle, bani tanë gur vorresh!"...

Haxhi Gani Balesi, (gjyshi i një shoku të fëmijërisë), me fesin e tij të bardhë e të gjatë karakteristik, një burrë zoganjor, që e kishim edhe komshi në Parrucë. Zotni Ramazani, një burrë i urtë, i moshuar, gjithmonë i qeshur, me teshpih në dorë e gojën që i lëvizte në heshtje, teksa bënte dhikër... (Ai kishte marrë pjesë edhe në ceremoninë e 16 nëntorit të famshëm të rihapjes së madhe të Xhamisë së Plumbit në vitin

## PËR TË MOS HARRUAR SE KUSH JEMI..!

1990. E shoh teksa falë të xhumanë e parë, diku në filmimin e asaj ceremonie madhështore).

Gjysh Ramazani, që e kishim komshi përballë shtëpisë së Gjyshit tim, që vetëm lexonte "Jasini Sherifin" dhe me zërin e tij të ëmbël e të butë, ngjante sikur nuk i përkiste botës së jashtme, të përzier me turlitakam mendimesh, intrigash, dallaveresh e hipokrizishë me veshje ateiste e afetare...

**NË FAKT, NE SI MUSLIMANË JEMI TË FTUAR SOT, TË MOS NEGLIZHOJMË HISTORINË TONË, QË FORMËZOHET NGA GURRA E SHPIRTIT TË KËTYRE BURRAVE TË URTË, QË JANË BREZA GARANCIE PËR RUAJTJEN E SHPIRIT TË TRADITËS DHE KULTIVIMIN E NUANCEVE TË IDENTITETIT TONË FETARO-KOMBËTAR.**

H. Halit Mertoshi, një Hoxhë i veshur me xhybe e çallmë, që përherë e kam dashur dhe më ka dashur. Sa herë e takoja kisha dëshirë ta përqafoja e të merrja bekimet e tij, që përziheshin me buzëqeshjet e tij tipike dhe urimet, që më bëhet se i dëgjoj akoma horizonteve...

Hafiz Mani i Dudasit, një burrë i paqhtë, që fliste me heshtje, aq sa nuk shprehej me fjalë, teksa rrezatonte bardhësinë e besës së dijes së bartur në thellësitë e qenies së tij, sidomos në vitet e errëta të persekutimit ateist...

Haxhi Emin Sheqi, Haxhi Faik Zaganjori, Haxhi Sylla, Haxhi Khoda, Haxhi Shabani, Haxhi Eljazi e shumë e shumë të nderuar të tjerë, që nuk e linin faltoren e Parrucës dhe nuk ndaheshin nga Myftiu i asaj kohe, Zotni Faik Hoxha...

Në mesin e tyre, ndoshta më i heshturi ndër ta, ishte edhe i urti Haxhi Hilmi Qazim Hoxha... Përherë, në një cep të xhamisë duke i mësuar dikujt leximin e Kur'anit... Sa e sa të rinj e të reja, të moshuar e jo vetëm, kanë mësuar të lexojnë Kur'an prej atij burri të nderuar,

që përherë më sillte ndër mend imazhin e babës së tij, që asnjëherë s'e kisha njohur, për shkak të kohës së largët të ndarjes së tij nga kjo botë, dekada para se të vija në jetë, por që përherë e kam lexuar dhe e lexoj me vëmendje për erudicionin e tij të spikatur në tefsirin e Kur'anit...

Ndjesia e dytë, ishte dhe vazhdon të jetë ajo e falënderimit dhe mirënjohjes ndaj veprimit të H. Fejzi Zaganjorit; nxitjen e organizimit të aktiviteteve përkujtimore në hak të burrave të nderuar besimtarë, që sot nuk janë më në mesin tonë.

Kohë më parë, në xhaminë e Rusit është përkujtuar edhe i nderuari Haxhi Hamza Cungu, muezini dhe besimtar i përkushtuar, që rrezatonte dashninë e imamëve dhe hoxhallarëve të rinisë së tij, si: Haxhi Muhamed Kastrati, Haxhi Muhamed Bekteshi, Sheh Qazim Hoxha, etj... E kam të gjallë intervistën që i kam bërë zotnisë tij në xhaminë e Rusit, teksa flet me ëmbëlsinë e zërit të tij për hoxhallarët e lartpërmendur, por jo vetëm.

Realisht, ne i jemi borxhli të shkuarve, shembullit të tyre, imazhit prej besimtarësh seriozë e korrektë me fenë e besimin, me qytetarinë dhe kodet e etikës islame dhe asaj kombëtare...

Në fakt, ne si muslimanë jemi të ftuar sot, të mos neglizhojmë historinë tonë, që formëzohet nga gurra e shpirtit të këtyre burrave të urtë, që janë breza garancie për ruajtjen e shpirtit të traditës dhe kultivimin e nuanceve të identitetit tonë fetaro-kombëtar.

Imamët tanë, myftilerët tanë, hatibët dhe vaizët tanë, (në veçanti), duhet të punojnë shumë për gjurmimin e tabanit qytetar islam shqiptar, për ruajtjen e shpirtit të traditës, për edukimin e brezit të ri në gjurmët e identitetit të baballarëve dhe gjyshërve të përkushtuar muslimanë, për nderimin e të shkuarve, për përkujtimin e tyre herë pas here, si për t'i përkujtuar vetes se kush jemi realisht, se kush janë të parët tanë, se kush duhet të jenë fëmijët tanë! Për të mos harruar se kush jemi..!

**Imam Muhamed B. Sytari**

*Shkodër, më 6 maj 2019*

*(E rishikuar, nga publikimi origjinal, 3 vite më parë)*





**Naim Drijaj,**  
Imam - xhamia Parrucë

## RAMAZANI, MUAJI I KUR'ANIT

“Kush dëshiron që ta dojë All-llahu dhe i Dërguari i Tij, le të loxojë Kur'an”.<sup>4</sup>

Katade ka thënë: “Jepuni jetë zemrave tuaja me Kur'an dhe jepuni jetë shtëpive tuaja, duke lexuar Kur'an në to”.<sup>5</sup>

Çdo gjë që lidhet me Kur'anin, bëhet madhështore

– Xhibrili (a.s) e zbriti Kur'anin pra ai u bë më i madhi i Melekëve.

– Muhamedit (a.s) i zbriti Kur'anit ai u bë zotëria i të parëve dhe të fundëve.

– Kur'anit i zbriti umetit të Muhamedit (a.s) dhe u bë umeti më i mirë.

– Kur'anit zbriti në mujin e Ramazanit, dhe e bëri këtë muaj të bekuar.

– Kur'anit zbriti në Natën e Kadrit, dhe kjo natë u bë nata më e mirë.

– Nuk ka dyshim që nëse Kur'anit zbrit në zemrat tona, do të bëhemi njerëzit më të mirë.

Uthman Ibn Affani (r.a) ka thënë: “Sikur të ishin të pastra zemrat tuaja, kurrë nuk do t'ju ngopeshin nga fjala e Zotit (nga leximi i Kur'anit)”.

Ibni Kajjim ka thënë: “Nëse dëshiron që të përfitosh prej Kur'anit, bëje që zemra jote të jetë prezent gjatë leximit dhe dëgjimit të tij”.

### I. VLERAT E KUR'ANIT TË PËRMENDURA NË AJETE

Vlerat dhe virtytet e Kur'anit janë të shumta dhe të panumërta. Vetë Kur'anit fisnik ka vënë në pah vlerat dhe virtytet e tij në shumë ajete. Më poshtë do të përmendim disa prej këtyre vlerave:

1. Kur'anit është mrekullia më e madhe e All-llahut: Kur'anit është mrekullia hyjnore e paimitueshme, e cila pohon dhe vërteton profetësinë e Muhamedit (a.s). All-llahu i Madhëruar ka sfiduar me këtë Kur'an të gjithë njerëzit dhe xhindët: “Thua: “Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin”.<sup>6</sup> All-llahu i lartësuar i ka sfiduar të gjithë njerëzit, që të sjellin qoftë edhe një sure të vetme: “Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robit tonë (Muhamedit a.s), atëherë hartoni një sure të ngjashme

me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj (që i adhuroni) në vend të All-llahut, nëse jeni të sinqertë”.<sup>7</sup>

2. Kur'anit është libër udhëzues për të gjithë botën: Kur'anit udhëzoi në rrugën e drejtë dhe i orienton njerëzit që të jenë të lumtur në dynja dhe ahiret. All-llahu (xh.sh) thotë: “Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit”<sup>8</sup> dhe: “Në të vërtetë, ky Kur'an udhëzoi drejt asaj që është më e mira”.<sup>9</sup>

3. Kur'anit është mjekim për sëmundjet (sociale dhe morale) individuale dhe shoqërore. All-llahu i lartësuar thotë: “Kur'anit është shërim dhe mëshirë për besimtarët”<sup>10</sup>, si dhe: “Thua: “Ai është udhërrëfyes dhe shërim për besimtarët”.<sup>11</sup>

4. Kur'anit është argumenti më i qartë: Kur'anit ua ka qartësuar të gjithë njerëzve të vërtetën dhe e ka rrëzuar të pavërtetën. Me Kur'an luftohet dhe ndryshohet e keqja. “Mos i dëgjo mohuesit, por luftoju ata me forcë nëpërmjet këtij (Kur'anit)”.<sup>12</sup>

5. Kur'anit është autoriteti më i lartë: Kur'anit ka pozitë më të lartë se çdo libër tjetër qiellor. All-llahu (xh.sh) thotë: “Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre”.<sup>13</sup> Kur'anit konfirmon dispozitat e vlefshme për çdo kohë e vend, si dhe anulon dispozitat që kanë qenë specifike për popuj të caktuar.

II. VLERAT E KUR'ANIT TË PËRMENDURA NË HADITHE

1. Kur'anit është fjala më e mirë që shqipton njeriu. Xhabir ibn Abdullahu (r.a) tregon, se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Nuk ka dyshim se fjala më e mirë është Libri i All-llahut dhe shembulli më i mirë është shembulli i Muhamedit (a.s)”.<sup>14</sup>

2. Kur'anit privilegjon lexuesin e tij: Uthman ibn Affani (r.a) tregon, se i Dërguari i All-llahut ka thënë: “Më i miri prej jush është ai, i cili e mëson Kur'anin dhe ua mëson atë të tjerëve”.<sup>15</sup>

7. Kur'anit, El-Bekare: 23.  
8. Kur'anit, El-Bekare: 2.  
9. Kur'anit, El-Isra: 9.  
10. Kur'anit, El-Isra: 82.  
11. Kur'anit, Fussilet: 44.  
12. Kur'anit, El-Furkan: 52.  
13. Kur'anit, El-Maide: 48.  
14. Transmetuar nga Muslimi.  
15. Transmetuar nga Buhariu.

3. Kur'anit u dhuron qetësi lexuesve të tij: Ebu Hurejrah (r.a) tregon, se i Dërguari i All-llahut ka thënë: “Sa herë që një grup mbledhet në një nga shtëpitë e All-llahut duke lexuar dhe studiuar Librin e All-llahut, mbi ta zbritet qetësia (shpirtërore), i përfshin mëshira, rrethohen nga melekët dhe All-llahu i përmend tek ata, të cilët janë tek Ai (tek melekët)”.<sup>16</sup>

4. Kur'anit ndërmjetëson për lexuesin e tij: Xhabiri (r.a) tregon, se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kur'anit është ndërmjetësues dhe i pranohet ndërmjetësimi, është nxitës për mirë dhe vërtetues (i besimit). Kush e vendos përpara syve (duke e zbatuar), Kur'anit do t'i prijë për në Xhenet. Kush e hedh pas krahëve (duke mos e zbatuar), Kur'anit do ta shtyjë për në zjarr”.<sup>17</sup> Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Lexoni Kur'anin, sepse ai (Kur'an) do të jetë ndërmjetësues për lexuesit e tij në Ditën e Kijametit”.<sup>18</sup>

5. Kur'anit lutet për lexuesin e tij: Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Në ditën e Kijametit, do të nxirret lexuesi i Kur'anit (në prezencë të All-llahut). Kur'anit do të thotë: “O All-llah! Zbukuroje (lexuesin e Kur'anit). Lexuesit të Kur'anit i vendoset kurora e nderimit (dhe bujarisë). Më pas Kur'anit thotë: “O All-llah! Shtoji atij (nderim)”. Lexuesi i Kur'anit stoliset me bujari. Kur'anit thotë: “O All-llah! Ji i kënaqur me lexuesin e Kur'anit”. All-llahu kënaqet me të. Më pas i thuhet lexuesit të Kur'anit: “Lexo dhe lartësohu (në shkallët e Xhenetit). Për çdo ajet që lexon, i shtohet një e mirë (ngrihet një shkallë)”.<sup>19</sup>

16. Transmetuar nga Muslimi.  
17. Hadith i saktë.  
18. Transmetuar nga Muslimi.  
19. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Hakimi.  
20. Kur'anit, Fatir: 29.

6. Dërguari i All-llahut ka thënë: “Kush lexon një shkronjë nga Libri i All-llahut, i shkruhet një e mirë (sevap) dhe e mira shpërblehet dhjetëfish. Nuk them që “Elif lam mim” është një shkronjë, por Elif është një shkronjë, Lam është një shkronjë dhe Mim është një shkronjë”.<sup>21</sup>

Duke qenë një adhurim madhështor, dijetarët i kanë kushtuar rëndësi hatmes së Kur'anit dhe kanë orientuar, që të zbatohen disa rregulla dhe etika në lidhje me të. Në vijim do të përmendim disa prej këtyre etikave:

- Leximi i Kur'anit sipas një afati të përcaktuar: Është e pëlqyeshme që Kur'anit të lexohet çdo muaj, apo çdo dyzet ditë, apo të paktën dy herë në vit. Abdullah ibn Amri (r.a) tregon: “E pyeta të Dërguarin e All-llahut se për sa ditë duhet të lexohet Kur'anit”? Ai (Paqja qoftë mbi të) më tha: “Për 40 ditë”, më pas tha: “Për një muaj”, më pas tha: “Për 20 ditë”, më pas tha: “Për 15 ditë”, më pas tha: “Për 10 ditë”, më pas tha: “Për 7 ditë” dhe nuk përmendi më pak se shtatë ditë.”<sup>22</sup>

Nuk është e pëlqyeshme, që Kur'anit të lexohet në më pak se tre ditë. Abdullah ibn Amri (r.a) tregon, se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Nuk vepron mirë (nuk e kupton Kur'anin siç duhet) ai, që e lexon Kur'anin në më pak se tre ditë”.<sup>23</sup>

Tregohet se Ibn Mes'udi (r.a) e bënte hatme Kur'anin çdo javë jashta Ramazanit, ndërsa në Ramazan çdo tre ditë e bënte hatme Kur'anin.<sup>24</sup>

Ebu Hanife ka thënë: “Kush e lexon të gjithë Kur'anin dy herë në vit, e ka shlyer detyrimin e leximit të tij, pasi i Dërguari i All-llahut e ka lexuar dy herë Kur'anin para Xhibrilit (a.s), në vitin e fundit të jetës së tij”.<sup>25</sup>

- Mbledhja e familjarëve/dashamirësve për të bërë bashkarisht duanë e hatmes së Kur'anit: Thabiti (r.a) tregon: “Kur Enes ibn Maliku (r.a) bënte hatmen e Kur'anit, mbledhte fëmijët dhe familjarët e tij dhe lutej për ta”.<sup>26</sup> Hakimi thotë: “Muxhahidi dërgoi një person të më tërë. Kur shkova tek Muxhahidi, ai më tha: “Të ftova, sepse deshëm të bëjmë hatme të Kur'anit. Kemi informata (nga ata që kanë jetuar me sahabët) se lutja pas hatmes së Kur'anit është e pranueshme, prandaj le të bëjmë sa më

21. Transmetuar nga Tirmidhiu.  
22. Transmetuar nga Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu.  
23. Transmetuar nga Buhariu.  
24. Shënon Bejhakia.  
25. El-Itkan fi Ulumi'l-Kur'an, 1/294.  
26. Transmetuar nga Darimiu dhe Bejhakia në “Shuabu'l-Iman”.

shumë lutje”.<sup>27</sup>

- Leximi i sures Fatiha dhe pesë ajeteve të para të sures Bekare menjëherë pas përfundimit të Hatmes. Ibn Abasi (r.a) tregon, se një person e pyeti Pejgamberin (a.s): “O i Dërguari i All-llahut! Kush bën punën më të mirë”? Ai (a.s) tha: “Ai, i cili sapo mbaron një punë, fillon një tjetër”? Personi e pyeti: “Ç'nenkuptojnë këto fjalë”? I Dërguari i All-llahut tha: “Ai që e lexon Kur'anin nga fillimi deri në fund dhe pastaj nis ta lexojë përsëri atë nga fillimi”.<sup>28</sup>

Ibn Abasi (r.a) transmeton, se Ubej ibn Kabi (r.a) ka thënë: “Sapo i Dërguari i All-llahut mbaronte leximin e “Kul eudhu birrabin-nas” (mbaronte hatmen e Kur'anit), lexonte suren Fatiha dhe ajetet e sures Bekare deri tek “Ulaike humul muflihun”. Më pas bënte lutjen e hatmes dhe ngrihej”.<sup>29</sup>

IV. MUKABELEJA

Me termin “mukabele” nënkuptohet leximi i plotë i Kur'anit përgjatë gjithë muajit të Ramazanit. Ky lexim bëhet në xhami dhe në prezencë të xhematit, duke lexuar çdo ditë një pjesë nga Kur'anit. Një nga traditat më të mira në vendin tonë ka qenë mukabeleja. Është përgjegjësi për muslimanët që ta ringjallin këtë traditë, e cila në të vërtetë bazohet në mukabelen që i Dërguari i All-llahut e bënte në prezencë të Xhibrilit (a.s) në muajin e Ramazanit.<sup>30</sup> Mendimi se mukabeleja është risi (bidat) në fe, nuk bazohet në asnjë argument sheriatik të konsiderueshëm.

E lusim All-llahun që ta bëjë Kur'anin famëlartë: pranverë të zemrave tona, largim të streseve dhe halleve tona.

I lutemi All-llahun që t'i bëjë ajetet kur'anore shpërblim për ne, pastrim për zemrat tona, qetësi për shtëpitë tona e lartësim për të gjithë muslimanët, kudo që ndodhen.

O All-llah mbushi zemrat tona me dashurinë për Ty, për fenë Tënde, për librin Tënd, për profetin Tënd dhe për të gjithë muslimanët.

27. Transmetuar nga Darimiu dhe Bejhakia në “Shuabu'l-Iman”.  
28. Transmetuar nga Tirmidhiu, Hakimi, dhe Darimiu.  
29. Dani në “Xhamiu'l-Bejan” dhe Ibn Xhezriu në “Neshr” 2/440-444. Për më shumë shiko “El-Itkan fi Ulumi'l-Kur'an”, 1/313.  
30. Për më shumë shiko: Buhariu, 6, 3220, 4997, 4998. Muslimi, 2308. Ebu Daudi, 2466. Hakimi, 2904.





**Idmir Plaku,**  
Imam - xhamia "Ebu Bekër"

**N**dër mirësitë e fesë islame është uniteti i muslimanëve në kryerjen e adhurimit të All-llahut, ashtu siç ka thënë All-llahu (xh.sh): "Vërtet, ky është besimi juaj, besimi i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuroni Mua". - (En-Nisa: 92)

All-llahu (xh.sh) e veçoi muajin e Ramazanit nga 11 -të muajt e tjerë të vitit. Këtë muaj e identifikoi si muaji i ymetit islam. Në ajetin kur'anor të obligimit të agjërimit, ku All-llahu thotë: "O ju që keni besuar, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, që të bëheni të devotshëm", tregohet jo vetëm një vazhdimësi e obligimit të agjërimit nga besimtarët e brezave dhe popujve të mëparshëm, por edhe si lidhje mes tyre rreth të vërtetës së adhurimit të Një Zoti të Vetëm. Obligimi i agjërimit si shtyllë e Islamit tregoi se siç thotë All-llahu (xh.sh): "Feja e vërtetë tek All-llahu është vetëm Islami." - (Al-Imran: 19)

Ramazani vjen tek ne për të na treguar se është muaji i bashkësisë muslimane. Prej urtësisë hyjnore ka qenë edhe zbritja e Kur'anit në muajin e Ramazanit, si sintezë e përsosjes e Shpalljeve të mëparshme. Zbritja e Kuranit në këtë muaj ka qenë edhe mrekulli, sepse pjesë e tërësisë së shpalljes ka qenë udhëzimi për njerëzit: "Udhërrëfyes për njerëzit". Padyshim që udhëzimi në besim është mirësia më e madhe që All-llahu i dhuron njeriut.

Agjërimi i muajit të Ramazanit krahas dobive individuale ka edhe dobi shoqërore. Ai na jep panoramën e një familjeje të madhe e shpërndarë në çdo cep të rruzullit tokësor. Ajo çfarë e lidhë dhe e mban të bashkuar këtë familje të madhe është ndjenja e besimit dhe edukata që buron prej tij. Muslimanët kudo që ndodhen në këtë muaj i nënshtrohen një rregulli dhe disipline

## RAMAZANI, MUAJI I BASHKËSISË MUSLIMANE

të veçantë. Një disipline që është për tu pasur zili në ditët e sotme nga shumë familje që jetojnë brenda mureve të së njëjtës shtëpi. Kjo disipline është për tu admiruar sepse për shkak të saj ekziston harmonia dhe barazia duke marrë në konsideratë edhe rastet e veçanta. Për këtë All-llahu (xh.sh) ka thënë: "Kushdo që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë".

Me këtë urdhëresë hyjnore All-llahu (xh.sh) ka unifikuar muslimanët në aspekt të besimit, adhurimit, moralit dhe ndjenjës së përgjegjësive. Të gjithë muslimanët agjërojnë për hir të All-llahut me nijet adhurimi, sipas një morali e kornize edukate Ramazani me ndjenjën e përgjegjësive për të përmbushur obligimet që kemi.

Atmosferën që krijon Ramazani në bashkësinë muslimane nuk ta afron asnjë muaj tjetër gjatë vitit. Zbritja e Kuranit dhe agjërimi në këtë muaj frymojnë qetësi shpirtërore që në jetën e kësaj bote. Muslimani që e kalon Ramazanin me leximin e Kur'anit e ka të sigurt kënaqësinë shpirtërore edhe në jetën tjetër në sajë të ndërmjetësisë së tyre. Ky është sekret i Ramazanit, aty ku besimtarët mblidhen për të lexuar e mësuar Kur'an zbrer mëshira e All-llahut aq më tepër duke qenë agjërueshëm.

Identifikimi i Ramazanit me zbritje të Kur'anit dhe agjërimin për bashkësinë muslimane ka një domethënie të madhe. Çdo Ramazan në jetën e besimtarëve është një përvjetor i madhueshëm përkujtimi i zbritjes së Kur'anit. Për këtë mirësi të All-llahut ndaj tyre, besimtarët i shprehim mirënjohje duke qenë agjërueshëm.

Çdo Ramazan është për bashkësinë muslimane një kujtesë për pozitën e tyre tek All-llahu (xh.sh) në raport me popujt e mëparshëm. All-llahu i Madhëruar thotë: "Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin; (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni All-llahun." - (Ali Imran: 110) Kur muslimanët e kuptuan pozitën e tyre dhe arsyen përse All-llahu (xh.sh) i bëri të tillë, arritën të linin gjurmë në historinë e njerëzimit. Çdo Ramazan vjen si kujtesë për muslimanët për domosdoshmërinë e praktikimit të Islamit. Ashtu siç besuan dhe e praktikuan brezat e parë të besimtarëve.

Falë bindjes së tyre të palëkundur në besim dhe unitetit të muslimanëve, All-llahu (xh.sh) u dha në Ramazan fitoren e Bedrit, ndonëse ishin të pakët në numër. U dha besimtarëve mundësinë për të hyrë triumfues në Mekë, pas largimit nga ajo duarbosh, për shkak se pohuan: "Zoti ynë është All-llahu". U shënuan këto fitore në Ramazan për besimtarët e brezave të parë sepse ata e përjetuan dhe e kaluan me sukses testin e besimit dhe vullnetit të tyre gjatë këtij muaji.

Agjërimi është më i miri edukator i individit dhe shoqërisë për të brumosur tek ata mirësinë e çiltërsisë në fjalë dhe e sinqeritetit në vepra. Prandaj me të drejtë Ramazani është konsideruar përherë si muaji i ndryshimit. Kushdo që vëzhgon jetën e muslimanëve, vit

**AGJËRIMI I MUAJIT TË RAMAZANIT KRAHAS DOBIVE INDIVIDUALE KA EDHE DOBI SHOQËRORE. AI NA JEP PANORAMËN E NJË FAMILJEJE TË MADHE E SHPËRNDARË NË ÇDO CEP TË RRUZULLIT TOKËSOR. AJO ÇFARË E LIDHË DHE E MBAN TË BASHKUAR KËTË FAMILJE TË MADHE ËSHTË NDJENJA E BESIMIT DHE EDUKATA QË BURON PREJ TIJ. MUSLIMANËT KUDO QË NDODHEN NË KËTË MUAJ I NËNSHTROHEN NJË RREGULLI E DISIPLINE TË VEÇANTË**

pas viti, para ardhjes dhe pas shkuarjes së tij, do të bindet me këtë realitet shoqëror, ku shtohen veprat e mira dhe pakësohen të këqijat. Falë kësaj ndjeshmërie të madhe ndryshimi e atmosfera që të afron ky muaj është i qartë. Kur gjymtyrët i nënshtrohen edukatës së agjërimit, sjellja e njeriut programohet sipas shpirtit të adhurimit. Familjes i bashkëngjitet harmonia në ngrohtësinë e iftarit dhe syfyrit, punës i afrohet adhurimi, shoqërisë ndjenja e xhematit dhe e xhamisë. Në të vërtetë kjo është ajo çfarë All-llahu kërkon nga

besimtarët gjatë adhurimit të Tij.

Ditët e Ramazanit nuk janë si ditët e tjera, ato janë ditë zemre, ditë të një frymëmarrje të programuar, të një shiriti 30 -të ditor. Gjatë këtyre ditëve zemra dhe organet e tjera i rikthehen natyrshmërisë së krijimit, larg ndjeshmërisë kafshërore. Ndërsa, natyra njerëzore i rikthehet natyrës së Ramazanit.

Ramazani është indikator besimi për shoqërinë dhe shtresat e saj. Siç thotë ndër të tjera edhe dr. Jusuf El-Karadavi, është "Pranvera e jetës islame, pasi në të rinovohet jeta e individit dhe e shoqërisë. Në të zgjohet ndjenja e besimit tek fëmijët, të rinj e të reja, forcohet tek të rriturit, shihet sakrifica tek të moshuarit për të ecur me ritmin e dinamikës së Ramazanit. Dinamikë e përcaktuar në akrepat e pesë kohëve të namazit të ditës. Në këtë muaj gjallërohen zemrat me besim dhe përkushtim, gjallërohet shoqëria me bashkëpunim, gjallërohet ndjenja e bamirësisë".

Agjërimi i këtij muaji nuk e veçon individin nga shoqëria përkundrazi e afron duke qenë i respektuar në brendësi të saj për sakrificën që bën. Karakteri shoqëror i shtyllave të Islamit është plotësues për njëra -tjetrën dhe inkurajues për shpërbllim të plotë në shlyerjen e gabimeve. Pikërisht këtë nënkupton edhe hadithi i Pejgamberit (a.s): "Kush agjëron Ramazanin dhe falet me besim dhe bindje, i falen të gjitha mëkatet e tij." Kjo për faktin se muaji i Ramazanit nuk është vetëm muaj agjërimi, por agjërim ditën dhe falje e teravisë natën.

Muajin e Ramazanit e kemi në mesin tonë. Tregohuni se jeni më të mirët ndër njerëz me besim e moral, përjetojeni Ramazanin në shoqërinë e mësimleximit dhe praktikimit të mësimave të Kur'anit. Ky është muaji i Ramazanit, përjetojeni si bashkësi muslimane me agjërim, namaz, përkushtim dhe bamirësi, garoni në vepra të mira. Mos harroni, ne jemi pjesë e ymetit të natës së Kadrit, natë e cila ka dhënë sihariqin e lindjes së ymetit islam. Lutuni gjatë këtij muaji e në veçanti në natën e Kadrit, për veten, familjen, të afërmit tuaj, shoqërinë e vendin ku jetojmë, që All-llahu tua lehtësojë, pranojë adhurimin dhe tua plotësojë dëshirat.

Së fundmi ju uroj nga zemra: Për shumë vjet Ramazanin, agjërim të lehtë dhe adhurime të pranuar.

*Ubadetu ibnus-Samit (r.a) transmeton se  
Pejgamberi (a.s) ka thënë:*

*"Ju erdhi Ramazani muaji i begative të Allahut  
në të cilin zbrer mëshira, fshihen gjynahet  
dhe pranohen lutjet. Allahu ju vështron  
duke bërë gara me njëri-tjetrin në adhurime  
dhe mburret me ju te melekët e Tij.  
Prandaj shpalojeni prej vetes tuaj vepra të mira,  
sepse i humbur dhe i dëshpëruar është ai njeri,  
i cili privohet nga mëshira e Allahut në këtë muaj."*

*(Tabaraniu)*





**P**rej tri ditësh, Myftinia Shkodër ka nisur “Mexhliset e Ramazanit 1440”, ku imamët teologë po mbajnë ligjëratat, që regjistrohen për t’u transmetuar edhe gjatë ditëve të Ramazanit në Tv1 Channel në emisionin tradicional: “Ramazani midis nesh”.

Ligjëratat e Ramazanit nisën ditën e hënë, më 29 prill 2019 në xhaminë “Ebu Bekër”, vijuan ditën e martë në xhaminë e Parrucës dhe u zhvilluan edhe pasditen e kësaj dite, më 1 maj 2019 në xhaminë e Urës së Bunës.

Ligjëratat do të vazhdojnë edhe ditën e nesërme, në xhaminë e Medresesë dhe ditën e xhuma, më 3 maj 2019 në xhaminë e “Dy Vajzave”, në orën 19.00.

Aktivitetet në pritje të Muajit Ramazan 1440 do të mbyllën me mbrëmjen fetare, që do të zhvillohet ditën e shtunë, më 4 maj 2019, ora: 19.00 në oborrin e xhamisë së Parrucës, ku do të ketë edhe një program artistik me ilahi, sikurse

## ATMOSFERË RAMAZANI NË XHAMITË E SHKODRËS



do të shpërndahej kalendari i Muajit Ramazan, Kur’ani në gjuhën arabe dhe ai me përkthim në gjuhën shqipe.

Myftinia Shkodër ju fton ta shfrytëzojnë kohën dhe të merrni begatitë e këtyre tubimeve me vlerë.

## MYFTIU TAKOI IMAMËT NË PRAG TË RAMAZANIT 1440/2019



**P**araditen e së enjtes, më 2 maj 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, takoi imamët e qytetit të Shkodrës, në një takim këshillues në prag të Ramazanit të sivjetshëm.

Myftiu vlerësoi aktivitetet e deritanishme si të dobishme për besimtarët, sidomos ligjëratat me vlerë të teologëve shkodranë, që i dhanë një atmosferë të pasur dy muajve që i paraprijnë Ramazanit.

Myftiu iu drejtua imamëve me një mesazh të gjatë, ku u përqendrua te domosdoshmëria e ruajtjes së familjes, gjallërimin të xhamive në Ramazan me qarkullimin e imamëve, konsolidimin e harmonisë në mesin e besimtarëve dhe përhapjen e shpresës në shoqëri.

U dhanë edhe udhëzimet e duhura për të garantuar ruajtjen e traditave të këtij Muaji me vlerë, sikurse u pasqyrua edhe një pjesë e aktivitetit të larmishëm në ditët e Ramazanit të sivjetshëm.

## U MBYLL CIKLI I LIGJËRATAVE NË PRAG TË RAMAZANIT 1440



**M**brëmjen e së xhumasë, më 3 maj 2019, nga xhamia e “Dy Vajzave”, u mbyll cikli pesëditor i ligjëratave në prag të Ramazanit 1440, që Myftinia Shkodër organizoi në disa prej xhamive të qytetit.

Sipas programit të lajmëruar, në xhamitë: “Ebu Bekër”, Parrucë, te Ura e Bunës, te Medreseja dhe e “Dy Vajzave”, u mbajtën 10 ligjëratat me dobi nga teologët: Idmir Plaku, Gilman Kazazi, Naim Drijaj, Durim Kasemi, Adem Pizga, Ruzhdi Plangaj, Adil Cukali, Ervil Kuçi, Lavdrim Hamja dhe Arben Halluni.

Aktivitetet u pasuan edhe nga këshillat dhe mesazhet e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, sikurse u ndoqën nga të interesuar të ndryshëm që patën mundësi të bëhen pjesë e këtij cikli me vlera.

Ligjëratat do të transmetohen edhe në Tv1 Channel, gjatë ditëve të Ramazanit, më vazhden e emisionit tradicional “Ramazani midis nesh”.

## MBRËMJE FESTIVE NË PRAG TË RAMAZANIT 1440/2019

**D**itën e shtunë, më 4 maj 2019, ashtu si ishte lajmëruar më parë, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë e Parrucës një mbrëmje festive me rastin e afrimit të Hënës së Re të Muajit Ramazan 1440.

Aktiviteti mbledhi besimtarë të shumtë, që kaluan momente të gëzueshme në prani të imamëve të nderuar, mesazheve të larmishme dhe ilahive të bukura të kënduara me plot emocion nga bilbilat e Prizrenit, vëllezërit Menduh dhe Denis Allajbeg, si dhe i nderuari Ergys Dyli.

Aktiviteti nisi me leximin e një pjese kur’anore nga medresisti Muhamed Muça.

Më pas, teologu Lavdrim Hamja, pasi uroi mirëseardhjen e të pranishmëve, prezantoi programin e larmishëm me mesazhe dhe ilahi, në prag të Muajit Ramazan 1440, i cili nis ditën e hënë, më 6 maj 2019.

Të pranishmit shijuan ilahitë e bukura të kënduara nga vëllezërit Allajbeg nga Prizreni, që dhuruan emocione dhe një atmosferë festive për besimtarët.

Mesazhe të përmbledhura dhanë edhe imamët e nderuar: H. Naim Drijaj, H. Adem Pizga, H. Ruzhdi Plangaj, H. Durim Kasemi, H. Lavdrim Hamja.

Aktivitetin e përhëndeti edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari,



i cili shprehu kënaqësinë e tij për këtë tubim festiv, që i paraprin fillimit të Muajit Ramazan 1440.

Myftiu u lut që Muaji Ramazan të jetë i begatë për Shkodrën, Shqipërinë dhe mbarë ymetin islam, sikurse falënderoi besimtarët dhe imamët për pjesëmarrjen

në aktivitetet dhe ligjëratat e larmishme të dy muajve të fundit, që i paraprinë Ramazanit të Begatë.

Për të pranishmit u shpërndanë edhe dhuratat e kësaj mbrëmjeje të shënuar, sikurse u fal edhe namazi i akshamit me xhemat.

## TERAVIA E PARË, DOMINON PRANIA E TË RINJVE



u krye falja e teravisë së shumëpritur, 20 rekatet e së cilës e gjallëruan xhaminë në këtë natë të parë të fillimit të Ramazanit 1440.

Edhe në xhamitë e tjera të Shkodrës, besimtarët kanë mbushur xhamitë, duke kryer adhurimet e kësaj nate dhe duke

uruar njëri-tjetrin për një agjërimit të mbarë e të pranuar.

Ajo që ra në sy, falë Zotit, ishte pjesëmarrja e madhe e të rinjve, numri i të cilëve, sa vjen e rritet.

Myftinia Shkodër ju uron: “Agjërimit të mbarë e adhurime të pranuar!”.



## HATMEJA E KUR'ANIT, TUBIMI TRADICIONAL I MUAJIT RAMAZAN

**E**dhe këtë vit, me fillimin e Muajit Ramazan, Myftinia Shkodër organizon tubimin tradicional të Hatmes së Kur'anit Famëlartë, leximin e plotë të Fjalës së All-llahut, çdo ditë pas namazit të iqindisë në xhaminë e Parrucës.

Pas faljes së namazit me xhemat, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mbajti një fjalë përshëndetëse, ku ligjëroi mbi vlerat e leximit të Kur'anit dhe atë të tubimit në xhami e shtëpi për të kryer këtë traditë të lashtë të Resulull-llahut (a.s.).

Myftiu ftoi të pranishmit që të angazhohen maksimalisht për të përfjetuar me përkushtim këtë tubim, që na lidh me Fjalën e All-llahut të Madhëruar; urdhëresat, ndalesat,



historitë, këshillat, urtësitë, etj.

Ai falënderoi edhe imamët që do marrin pjesë me xhematin për të

realizuar me mbarësinë e All-llahut këtë mirësi, duke theksuar se shpërblimi i tij aktiviteti është i madh.

## MYFTINIA SHKODËR DHURON NDIHMA PËR SHOQATËN E PARA & TETRAPELGJIKËVE



**P**as dreken e të martës, më 7 maj 2019 Myftinia Shkodër dhuroi për shoqatën e invalidëve Para & Tetrapelgjikë, dega Shkodër 40 pako ushqimore për njerëzit në nevojë të kësaj shoqate, ndihmë e Qendrës Humanitare Bamirëse "Mbreti Selman", Arabia Saudite.

Kryetari i shoqatës së invalidëve Para & Tetrapelgjikë, z. Saimir Beqiri falënderoi Myftininë e Shkodrës për këtë bashkëpunim dhe këtë ndihmë me vlerë për këta persona me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ai uroi të gjithë besimtarët myslimanë, muajin e begatë të Ramazanit.

Në emër të Myftinisë Shkodër përshëndeti teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së "Dy Vajzave", i cili tha se, kjo ndihmë nuk konsiderohet bamirësi, por është detyrë dhe amanet për këta vëllezër dhe motra të sprovuar, të cilit i kemi për detyrë tu gjendemi pranë dhe t'i përkrahim me sa kemi mundësi.

Myftinia Shkodër u bën thirrje biznesmenëve dhe të gjithë atyre që kanë mundësi, të kontribuojnë për njerëzit në nevojë dhe shtresat e varfra.

## RINIA FREKUENTUESE NË RITJE E XHAMIVE TË SHKODRËS



**M**e fillimin e Ramazanit të sivjetshëm, në të gjitha xhamitë e Shkodrës po vihet re prania përherë në ritje e të rinjve që prezantojnë në faljen e namazeve ditore, si dhe për namazin e teravisë.

Edhe ditën e xhuma të parë të këtij Ramazani, më 10 maj 2019, në xhamitë kryesore të Shkodrës u vu re prania e të rinjve të shumtë shkodranë, që po e gjejnë veten në mësimet dhe udhëzimet e minbereve tona.

Është për t'u përmendur edhe nisma e re e Myftinisë Shkodër për qarkullimin e imamëve dhe hatibëve të xhumasë në xhami të ndryshme, gjë që krijon larmi dhe gjallëri në xhamitë e shumta të Shkodrës.

Sipas programit të afishuar më parë, në të gjitha xhamitë e Shkodrës, ditën e sotme u mbajtën hytbe, në thelbin e të cilave ishte vlera dhe dobitë e agjërimit, vlera e lutjes, e pendimit, begatia e adhurimit, kthimi nga udhëzimi islam, etj.

## SOFRA E IFTARIT, DËSHMI E VËLLAZËRIMIT DHE HARMONISË



Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari ndau urimet e këtij Muaji, si dhe urimet më të mira për mbarësi dhe suksese, me kryetarin e Shoqatës

"Istanbul", z. Ridvan Seferaj dhe drejtorin e Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, sikurse u lut për pranimin e adhurimeve dhe lutjeve.

## AKTIVITET RAJONAL MBI VLERAT E HARMONISË NDËRFETARE



**D**itën e diel, më 12 maj 2019, në hotelin Mediteran në Ulqin, Instituti IDEA në bashkëpunim me komunën e Ulqinit realizoi konferencën me titull: "Ta ruajmë harmoninë ndërfetare", ku mblodhi figura të ndryshme të jetës politike, deputetë, përfaqësues të pushtetit lokal dhe të institucioneve tjera në vend, prijës fetarë, si dhe të shoqërisë civile.

Të ftuarit në panel ishin prijësit e tri komuniteteve fetare të Shkodrës, të cilët referuan mbi vlerat dhe rëndësinë e harmonisë në mesin e besimeve dhe besimtarëve, si dhe rëndësinë e saj për shoqëritë njerëzore.

Në këtë aktivitet mori pjesë edhe sekretari i këshillit të Myftinisë Shkodër, H. Fejzi Zaganjori, si dhe teologu Lavdrim Hamja, i cili lexoi edhe referatin e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Sipas lajmit të publikuar nga organizatori: "Tubimi kishte për qëllim temën e ruajtjes së harmonisë fetare si

vlerë e cila duhet kultivuar me kujdes sidomos në këto kohë të trazirave globale.

Herën e kaluar të konferencës sonë ishin të ftuar prijësit e bashkësive fetare të komunës së Ulqinit, ndërsa kësaj radhë bordi drejtues i Institutit IDEA, përzgjedhi që të ftuarit të ishin prijësit e tri bashkësive fetare të Shkodrës, duke na ofruar mesazhet e tyre të bashkëjetesës dhe harmonisë fetare të Shkodrës, si djepi i kësaj harmonie.

Në emër të Komunës së Ulqinit, fjalën përshëndetëse e mbajti nënkryetarija e komunës së Ulqinit, Hadixha Gjoni. Gjithashtu organizimin e tubimit e përshëndetën edhe pjesëmarrësit tjerë.

Pas konferencës u shtrua Sofra e Iftarit, "Sofra e Harmonisë Ndërfetare" në restorantin IDEA në Ulqin. Sofra e iftarit u përcoll me mesazhe pozitive nga tre komunitetet e lartpërmendura.

Këtë aktivitet e përcollën mediat lokale si dhe ato nga rajoni, si: RTK e Kosovës si dhe Zëri i Amerikës."

## SOFRA E IFTARIT, SOFËR E VËLLAZËRISË NË MESIN E SHQIPTARËVE



**M**brëmjen e të martës, më 14 maj 2019, me ftesë të Kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Mr. Besim Berisha, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në iftarin tradicional që shtrën Bashkësia Islame e Prizrenit.

Me këtë rast, Myftiu uroi Kryetarin e K.B.I të Prizrenit për muajin e Ramazanit, sikurse ndau me të lutjet më të mira për mbarësi dhe suksese për të dy myftinitë dhe kuadrin, që shërben për përhapjen e vlerave të besimit dhe harmonisë kombëtare.

Në përshëndetjen e bërë gjatë iftarit të shtruar, Myftiu i Shkodrës u lut që All-llahu i Madhëruar ta pranojë agjërimitin e këtij muaji, si dhe të shërbejnë këto takime, si ura lidhëse në mesin e muslimanëve dhe shqiptarëve, për t'u dëshmuar si besimtarë të përkushtuar në rrugën e përhapjes së vlerave në shoqëri.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu së bashku me grupin e imamëve dhe këshilltarëve, fali edhe namazin e teravisë në xhaminë e Sinan Pashës.



**D**itën e diel, më 12 maj 2019, qytetin e Shkodrës e vizitoi një mik i veçantë. Në atmosferën e Muajit të begatë të Ramazanit 1440, besimtarët muslimanë patën mundësi të falen pas imamit të ardhur nga Meka e bekuar, Dr. Fejsal El-Amri.

Miku nga vendet e shenjta u prit fillimisht nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, që e njohu atë me qytetin e Shkodrës dhe disa prej zonave të spikatura të tij, si: Xhamia e Plumbit, kalaja e lashtë e qytetit, lagjja e Tabakut, etj.

Më pas, gjatë iftarit që Myftiu shtroi për nder të imamit të nderuar nga Meka, i dëshiroi atij qëndrim të këndshëm në Shkodër, si dhe diskutoi me të mbi etapat e përhapjes së fesë islame në Shkodër dhe realitetin e sotëm, me të cilin përballet Thirrja Islame.

Një moment i veçantë i kësaj vizite ishte edhe mbërritja në xhaminë e Parrucës, ku besimtarë të shumtë ishin mbledhur për të falur namazin e teravisë dhe për të dëgjuar imamin mik.

Pas faljes së namazit të jaciesë, Myftiu lajmëroi xhematin se sonte na ka ardhur

## IMAMI NGA MEKA DREJTON NAMAZIN E TERAVISË NË XHAMINË E PARRUCËS



Meka dhe Medina në Shkodër, duke ftuar xhematin për të shijuar faljen pas imamit nga vendet e shenjta.

Në ligjëratën e mbajtur pra besimtarëve, Dr. Fejsal El-Amri, ftoi besimtarët të shfrytëzojnë muajin e Ramazanit për të mbërritur në gradën e lartë të përkushtimit me zemër.

Ai nxiti të pranishmit drejt moralit dhe virtyteve më të larta, që e karakterizojnë muslimanin, sikurse porositi edhe motrat muslimane për të vlerësuar këtë muaj dhe

për të forcuar lidhjen me besimin dhe moralin e fesë.

Më pas, nën drejtimin e tij, besimtarët falën 20 rekatet e teravisë, duke përjetuar një kënaqësi të madhe, si të ishin në xhamitë e shenjta të Mekës dhe Medines.

Pas përshëndetjes me besimtarët e shumtë, imami i nderuar bashkëbisedoi edhe me imamët dhe teologët e pranishëm në këtë mbrëmje të paharruar në xhaminë e Parrucës.

## MYFTIU LIGJËROI NË QENDRAT ISLAME SHQIPTARE NË LOZANË, GJENEVË DHE ZYRIH



Myftiu mbajti edhe ligjëratën, që i paraprën namazit të jaciesë dhe teravisë, ku vuri theksin tek leximi i thelluar i konceptit të "Sunetit" në jetën e muslimanit, duke e pastruar traditën e Hz. Muhamedit (a.s.) nga abuzimet flagrante të dekadave të fundit dhe rrëshqitjes së habitshme drejt konkluzioneve sipërfaqësore dhe përçarëse të traditave shekullore dhe shfaqjes së qytetëruar të muslimanit në jetë.

Të dielën, më 19 maj 2019, Myftiu ligjëroi në aktivitetin e xhamisë shqiptare "Drita" në Gjenevë, ku foli mbi rëndësinë e leximit me meditim të Kur'anit Famëlartë dhe rrezikut të devijimit të muslimanëve në shembullin dekadent të benit israilëve në marrëdhënie me Librin e Shenjtë.

Në këtë aktivitet ligjëroi fillimisht edhe personaliteti i shquar i mendimit islam në trojet shqiptare, H. Shaqir Fetahu, Myfti i Gostivarit.

Me rastin e kësaj vizite në Gjenevë, Myftiu ndau edhe urimet e përzemërta me rastin e Muajit Ramazan 1440, me imamin e kësaj qendre, H. Rijad Aliu me bashkëpunëtorë.

Ndërkohë, në mbrëmje, Myftiu ligjëroi



në xhaminë e Fondacionit të Rinisë Islame në Zyrh, ku foli mbi vlerat e rikthimit të njeriut nga Zoti, nëpërmjet dyerve të lutjes, sidomos në Muajin e Kur'anit dhe lutjes.

Myftiu zhvilloi edhe një bashkëbisedim me drejtuesin e këtij fondacioni të mirënjohur për shërbimet e vyer ndaj muslimanëve shqipfolës, z. Lulzim Lecaj, sikurse shprehu vlerësimet e tij për aktivitetin e RTV Islam dhe botimeve të shumta e me dobi, që kryen Fondacioni i Rinisë Islame në Zvicër.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu takoi edhe imamin e xhamisë "Ikre" në Brutisellen, z. Shaban Azizi me të cilin zhvilloi një bashkëbisedim vëllazëror.

**M**brëmjen e së enjtes, më 16 maj 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ishte i ftuar në emisionin "Perspektivë", në Tv1 Channel, ku dha mesazhe të shumta që lidhen me agjërimin e Ramazanit, vlerën e Kur'anit, reflektimin e agjërimin tek besimtarët, etj.

Myftiu vuri në pah rëndësinë e madhe që ka Muaji Ramazan, si një mundësi e madhe që i ofrohet besimtarëve muslimanë për të vendosur në ekuilibër të shëndoshë marrëdhënien me All-llahun e Madhëruar, Zotin e vetëm të gjithësisë.

Ai tha se agjërimi e ndihmon njeriun për të reflektuar në rrugën e gjetjes së dritës së besimit në jetë.

Myftiu kërkoi që atmosfera e Ramazanit të reflektohet edhe në jetën e përditshme, në rrugë, në institucione, kudo ku njerëzit kanë mundësi të shohin dhe të kuptojnë se këto ditë janë të

**M**brëmjen e së hënës, më 20 maj 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ishte i ftuar në emisionin "Tonight" në StarPlus Tv, ku bashkëbisedoi mbi temën e Ramazanit me gazetarin Erzen Koperaj.

Ndër të tjera Myftiu vlerësoi se muaji Ramazan është muaj i forcimit të familjes dhe farefisit, ku solli në vëmendje të teleshikuesit edhe mirësinë e madhe të pranisë së prindërve, si një bekim i garantuar në këtë sofër bujare.

Duke folur për sofrën e iftarit, shpjegoi: "Ne themi shpesh se Ramazani është muaji i familjes, i shoqërisë, duke u nisur edhe nga fakti i shtimit të sofrave të iftarit. Nuk është meseleja për të ngrënë a për të pirë. Çështja është tek syri, tek zemra, tek fytyra e qeshur, me të cilën ne komunikojmë."

Unë po flas për veten dhe për familjen time. Ne përherë me prindërit. Dhe i them krejt të rinjve: Ai që ka mundësi të jetë

**D**itën e martë, më 21 maj 2019, në kuadër të aktiviteteve bamirëse që karakterizojnë Muajin e begatë të Ramazanit, Fondacioni "Mirësia" në bashkëpunim me Myftininë Shkodër, mundësoi shpërndarjen e "Shportës së Ramazanit" për fëmijët e xhamive Krye-Bushat dhe Mjedë.

I pranishëm në shpërndarjen e kësaj mirësie ishte edhe drejtori i fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, si dhe përgjegjësi i arsimit në Myftininë e Shkodrës, teologu Arben Halluni.

## MYFTIU I FTUAR NË TV1 CHANNEL PËR VLERAT E RAMAZANIT



veçanta, ditë adhurimi, pajtimi, faljeje, bamirësie dhe lartësimi në gradët më të larta të besimit.

Ai foli edhe mbi vlerën e Natës së Kadrit, si nata në të cilën filloi shpallja

e Kur'anit. Ai tërhoqi vëmendjen e teleshikuesit se ky moment na shërben për të parë më me vëmendje Librin e All-llahut, i cili mbetet garanci dhe siguri për njerëzimin.

## MYFTIU: "PRANIA E PRINDËRVE ËSHTË GARANCI BEKIMESH PËR JETËN!"

me prindërit, gjithmonë të jemi me prindërit! Kur je me prindin, sado i shturur të jesh, sado i hutuar të jesh, ty do të zënë bekimet e prindit tënd! Prindin e kemi derën garant të llasimit para duarve të Zotit!

Bekimet e prindit dhe prezenca e tyre janë garanci hyjnore për jetën tonë! Në muajin e madhërisëm të Ramazanit, sofrat e iftarit me prezencën e nënës dhe babës janë sofa më të shtrenjta se me këdo tjetër në botë!

Edhe nëse nuk kemi asgjë tjetër në tryezë, mjafton që kemi fytyrën e qeshur të prindit, praninë, fjalët dhe

zërin e këtyre dy njerëzve të shenjtë e të shtrenjtë!

Përndryshe, sofa në të cilën bashkohemi me vëllanë, me motrën, me axhën, me hallën, me dajën, me tezen, është sofër e shenjtë, sepse është mbledhur farefisi!"

## "SHPORTA E RAMAZANIT" PËR FËMIJËT NË KRYE-BUSHAT DHE MJEDË





**M**brëmjen e së mërkurës, më 22 maj 2019, Myftinia Shkodër organizoi "Iftarin e bujarisë shkodrane", ku ishin të ftuar autoritete të qytetit, drejtues të komuniteteve fetare, shoqatave bamirëse, drejtues të myftinive Prizren dhe Ulqin, imamë e këshilltarë, pedagogë dhe intelektualë të qytetit të Shkodrës.

Në këtë sofrë të harmonisë ishte i pranishëm edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu me bashkëpunëtorë.

Në prag të iftarit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre, sikurse u lut që All-llahu i Madhëruar ta begatojë Shkodrën dhe shkodranët, Shqipërinë dhe shqiptarët në krejt trojet tona, si dhe të mbulojë njerëzimin me mëshirën dhe bekimet e Tij.

Një urim me rastin e kësaj mbrëmjeje dha edhe Kryetari i KMSH-së, i cili

## "IFTARI I BUJARISË SHKODRANË", SOFRA TRADICIONALE E MUAJIT RAMAZAN



vlerësoi tubimin e autoriteteve të qytetit të Shkodrës, drejtuesve të komuniteteve fetare, miqve dhe vëllezërve nga Prizreni dhe të pranishmëve në këtë natë Ramazani, sikurse u lut për paqe e begati për vendin dhe mbarë njerëzimin.

Iftari u shoqërua me biseda të dobishme dhe këmbim të urimeve, që nuk munguan edhe nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, si dhe ish-Kryetari i K.B.I. Prizren, H. Lutfi Ballek dhe Kryeimami i Ulqinit, Mr. Ali Bardhi.

## KËSHILLA NË PRAG TË 10 DITËVE TË TRETA TË RAMAZANIT

*Të dashur dhe të shtrenjtë besimtarë muslimanë,*

**T**ashmë që po bëhemi gati të mbërrijmë periudhën e tretë të Muajit të begatë të Ramazanit 1440, më lejoni t'ju drejtohem me disa këshilla, me qëllimin e mirë të shfrytëzimit të kohës dhe mundësive të mëdha që na ofron Zoti i gjithësisë nëpërmjet këtij Muaji!

Të shfrytëzojmë maksimalisht kohën për kryerjen e namazeve me xhematë në xhami, duke dëshmuar bindje dhe respekt ndaj thirrjes së shenjtë të ezanit.

Të shfrytëzojmë netët e mbetura të këtij Mubarek, për të falur të plotë namazin e teravisë me xhematë në xhami, duke dalë nga xhamia pasi imami të ketë kryer, si dhe të përgatisim familjen për lutje e adhurime shtesë në shtëpitë tona.

Të qëndrojmë larg debateve, grindjeve, fyerjeve e sharjeve, të cilat e prishin përshpirtjen e Ramazanit. Ruaje gjuhën me të cilën i bën dhikër All-llahut, me të cilën i falesh dhe i drejtohes me lutje. Gjuha e jote përkthen më së miri gjendjen e zemrës.

Kush ka mundësi të shtrojë iftar a të këmbejë një hurmë a një gotë uji me tjetrin, mos ta neglizhojë. E pakta në sytë tonë, është më e madhe, sesa mund

ta perceptojmë, tek Zoti ynë!

Të shfrytëzojmë kohën për të bërë një hatme Kur'ani. Nëse nuk e ke nisur akoma, shpejto se koha është e çmuar në Ramazan.

Lutu dhe kërkoni nga Zoti yt më të mirën e mundshme! Lutuni për familjen, për prindërit, për të afërmit, për



shoqërinë, për bashkëqytetarët e atdheut tënd! Mos harro në lutje hakun e vëllazërisë së shenjtë islame, sepse ymeti i Hz. Muhammedit (a.s.) janë një familje e madhe vlerash.

Shtojte dhikrin dhe lutuni që All-llahu i Madhëruar të të japë mbarësi të jesh korrekt me virdin tënd ditor.

Shtojte vizitën e xhamive të shumta që kemi, elhamdulillah, për faljen e namazeve të ndryshme, sepse toka do të dëshmojë për ty në ditën e gjykimit.

Shfrytëzoje kohën për vepra të dobishme, mos e humb atë, sepse nuk ka pendim më të madh, por më të pavlerë, sesa pendimi për kohën e humbur.

Trego mëshirë ndaj krijesave të Zotit, dëshmo qytetari e afrohu me Zotin tënd nëpërmjet shpërndarjes së mirësisë. Mëshiruesit i mëshiron Mëshiruesit!

Mos e humb ditën e agjërimit para tv, rrjeteve sociale e bisedave të padobishme, që të hutojnë e të marrin shpërblimet e mundshme të Ramazanit.

Prezanto në mexhliset e dijes dhe mos lër asnjë ditë të të kalojë pa një dobi, me të cilën gjallëron zemrën, ndriçon mendjen, lartësohesh drejt pëlqimeve të Zotit tënd.

Jep sadeka dhe ndihmo atë që ka nevojë. Mos e paragjyko vlerën materiale të saj, mendo për dobinë që i sjell dikujt nëpërmjet saj! Sadekaja shton begatinë dhe të zbut zemrën.

Buzëqesh se buzëqeshja është fisnikëri që shpërblehet tek Krijuesi i gjithësisë.

All-llahu ju pranofte adhurimet, bamirësitë e sakrificat tuaja! All-llahu ju dashtë e ju pastë në mbrojtje!

Myftiu i juaj,  
**Imam Muhamed B. Sytari**

*Shkodër, më 23 maj 2019*

**D**itën e enjte, më 23 maj 2019, në kuadër të veprimtarive bamirëse që shoqërojnë Muajin e begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër ka vazhduar të shpërndajnë ndihma për personat me aftësi të kufizuar, duke iu përgjigjur thirrjes së drejtuesve të shoqatës "Në ndihmë të personave me aftësi të kufizuar mendore", dega Shkodër.

Përfaqësuesi i Myftinisë, z. Lavdrim Hamja, me këtë rast tha: Këto ndihma janë dhuratë nga Qendra Humanitare "Mbreti Selman" në Arabinë Saudite në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, ku në të gjithë Shqipërinë janë shpërndarë 7300 pako ushqimore.

Z. Hamja ndër të tjera tha, se: Ne ua kemi borxh këtyre personave dhe këta vëllezër dhe motra janë amanet dhe ne duhet ta kryejmë këtë amanet!

Ai shtoi se, institucionet përgjegjëse shtetërore dhe lokale duhet të bëjnë më shumë për këta njerëz, duke bërë detyrën

## "TË NDIHMOSH PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR ËSHTË AMANET!"



që u takon dhe t'u sigurojnë atyre kushte më të mira dhe t'ua plotësojnë nevojat që kanë. Gjithashtu, ai u bëri thirrje edhe biznesmenëve, por jo vetëm, që edhe ata të kontribuojnë për shtresat e varfra dhe njerëzit në nevojë dhe të japin prej

mirësive dhe begative që Zoti u ka dhënë.

Në emër të shoqatës, foli sekretarja znj. Vitore Toma, e cila falënderoi Myftininë Shkodër, që iu përgjigj kërkesës së tyre, duke shpërndarë ndihma për anëtarët e kësaj shoqata.

## MYFTINIA SHKODËR NË NDIHMË TË FAMILJES CEKA NË KULLAJ



**P**araditen e së dielës, më 26 maj 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar nga stafi i tij, vizitoi shtëpinë e z. Muhamed Ceka në fshatin Kullaj, Postribë.

Ai pa nga afër gjendjen e mjeruar të kësaj familjeje me katër fëmijë, të cilët jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira, pa punë, pa të ardhura, pa drita e pa ujë.

Myftinia Shkodër i bën thirrje besimtarëve të kontribuojnë për këtë familje. Duke nisur nga e xhumaja e ardhshme, në xhamitë e zonës së Postribës, por jo vetëm, do të bëhet thirrje për të ndihmuar këtë rast.

Myftiu falënderoi edhe koordinatoren e Myftinisë Shkodër, z. Zamir Milani për kontributin e tij për evidentimin e këtij rasti urgjent.

Myftinia Shkodër shpreh mirënjohjen për banorët e zonës së Postribës, sidomos për vëllezërit tanë në emigrim, që nuk janë kursyer për të ndihmuar në kësi rastesh. All-llahu jua shpërbleftë me gëzime e bekime në familjet e tyre.

## IFTARI I BASHKISË USKUDAR PËR AGJËRUESIT SHKODRANË

**D**itën e hënë, më 27 maj 2019 u organizua një iftar i veçantë nën kujdesin e Ambasadës së Republikës së Turqisë në Tiranë, me mbështetjen e Bashkisë Ūskudar të Stambollit, të shoqatës "Istanbul" dhe në bashkëpunim me Myftinë Shkodër.

Fillimisht, z. Ridvan Seferaj, kryetar i shoqatës "Istanbul" uroj të pranishmit dhe falënderoi të gjithë ata që kontribuuan për shtrimin e këtij iftari, ambasadorin e Turqisë në Tiranë, z. Murat Ahmet Yörük, Bashkinë Ūskudar të Stambollit, Myftininë e Shkodrës dhe Bashkinë Shkodër për gatishmërinë, që tregoi për realizimin e iftarin në ambientet e pallatit të sportit.

Pastaj, përshëndeti përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Lavdrim Hamja, i cili përcjelli urimet dhe lutjet e përzemërta të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari dhe gjithashtu falënderoi organizatorët dhe kontribuuesit e këtij iftari. Teologu Hamja, ndër të tjera tha, se ndihmat e Turqisë për Shqipërinë kanë qenë të përhershme dhe të vazhdueshme, jo vetëm në fushën fetare, por në çdo fushë që vendi ynë ka pasur nevojë. Ai falënderoi për z. Murat Ahmet Yörük për ndërtimin e xhamisë së madhe në Tiranë, si dhe për mbështetjen me imamë-hafizë,



që Dijaneti i Turqisë dërgon me vite me radhë në Shkodër për muajin e begatë të Ramazanit.

Më pas përshëndeti znj. Voltana Ademi, kryetare e Bashkisë Shkodër, ku falënderoi të gjithë ata që kontribuuan për këtë iftar të begatë, në këtë muaj të shenjtë të Ramazanit.

Ndërsa, z. Murat Ahmet Yörük, ambasadori i Turqisë në Tiranë, pasi përcolli urimet dhe përshëndetjet e përzemërta të presidentit të Turqisë, z. Recep Tayyip Erdoğan, ndër të tjera tha, se "është shumë mirë fakti që i përkasim një feje e cila ka si motiv të rëndësishëm bindjen se nuk është prej nesh ai që fle i ngopur ndërkohë që fqinji i tij është i uritur".

Në përfundim të iftarin, z. Yörük shpërndau edhe disa dhurata për fëmijët, të cilët morën pjesë në sofrën e begatë të këtij iftari.



**N**ën kujdesin e Mbretit Selman bin Abdulaziz të Arabisë Saudite, në datat 27-30 maj 2019, Liga Botërore Islame zhvilloi në Mekë konferencën ndërkombëtare me temë: "Vlerat e qëndrimit të moderuar dhe mesatar në tekstet e Librit dhe të Traditës profetike", ku morën pjesë mbi 1200 myftilerë, studiues islamë, mendimtarë e drejtues të organizatave ndërkombëtare islame, nga 139 shtete të botës.

Në seancën e hapjes morën pjesë prijës të shumtë fetarë, drejtues organizatash ndërkombëtare dhe udhëheqës nga vende të ndryshme të botës islame.

Sekretari i Përgjithshëm i Ligës së Botës Islame, Shejkh Dr. Muhammed bin Abdulkerim El-Isa, u shpreh se kjo konferencë ndërkombëtare është e një rëndësie të veçantë, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat po kalon mbarë bota islame.

Ai theksoi se konferenca po ndiqet nga një grup i madh dijetarësh, myftilerësh, zyrtarësh të lartë dhe mendimtarësh nga mbarë bota islame.

Në seancat e kësaj konference u diskutua rreth temës së moderimit dhe

## "KARTA E MEKËS", KONFERENCA HISTORIKE E LIGËS BOTËRORE ISLAME



mesatares, kuptimeve të armishme dhe domethënive të thella të tyre, tiparet e moderimit dhe parimet e tij në fenë islame, bazuar në ajetet kur'anore dhe hadithet profetike, efektet dhe rrethanat e padijes mbi konceptet e moderimit, etj., ku dijetarë të shquar të botës islame diskutuan përgjatë seancave të konferencës.

I pranishëm në këtë takim, me ftesë të veçantë nga Liga Botërore Islame, ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili gjatë kësaj konference me

vlera të veçanta, zhvilloi edhe disa takime me pjesmarrës të ndryshëm në këtë takim botëror, si nga: Turqia, Argjentina, Bullgaria, Çeçenia, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Dagestani, Rumania, Bosnja dhe Hercegovina, Novi Pazari, Serbia, Kosova, Korea e Jugut, Australia, Libani, etj., me të cilët diskutoi rreth temave me interes të përbashkët.

Konferenca kulmoi me shpalljen e "Kartës së Mekës", të cilën organizatorët e konferencës e përshkruan si një vendim historik për mbarë botën islame.

## IFTAR VËLLAZËROR NGA MESHIHATI DHE MEXHLISI I B.I ULQIN



**T**e martën më, 28.05.2019 Meshihati i B.I. në Mal të Zi dhe Mexhlisi i B.I. Ulqin shtruan një iftar të përbashkët për miqt, afaristat dhe bashkëpunorë e vet.

Në iftar morën pjesë Reisi Rifat ef. Fejziq së bashku me bashkëpunorët e vet nga Meshihati, nënkryetari i parlamentit të MZ.z.Genci Nimanbegu, kryetari i KKSH z. Faik Nika, kryetari i komunës së Ulqinit z. Loro Nrekiq, kryetari i kuvendit z. Ilir Çapuni, ambasadorja e Turqisë znj. Söngül Ozan, koordinatori i Tika-s z.Enver Resuloğulları,

nga Bashkësia Islame Prizrenit kryetari Besim ef.Berisha dhe kryeimami Orhan ef.Bislimaj si edhe përfaqësuesi nga Myftinia e Shkodrës Naim ef.Drijaj nga ku institucionet e këtyre dy të fundit janë të binjakëzuara me Mexhlisin e B.i.Ul.

Si fillim, fjalën hyrëse dhe mirëseardhjen e misafirëve e bëri Kryeimami, më pas përshëndeten përfaqësuesit e myftinisë së Prizrenit dhe të Shkodrës, kryetari i komunës z.Loro Nrekiq dhe në fund Reisi Rifat ef. Fejziq mbajti një fjalim për të pranishmit.

(Me shkurtime nga:  
Bashkësia Islame – Ulqin)

## BASHKËBISEDIM NË TV1 CHANNEL MBI NATËN E KADRIT



**P**asditën e së enjtes, më 30 maj 2019, teologët dhe vaizet e nderuara, znj. Zamira Puka dhe znj. Ferzet Ndoja ishin të ftuara në emisionin "Pasdite në Tv1" të gazetares Sidola Osja për të diskutuar mbi rëndësinë dhe mirësinë e Natës së Kadrit.

Përmes bashkëbisedimit të ngrohtë, të dy teologët hodhën dritë mbi madhësinë e kësaj Nate të Begatë, për të cilën në Kur'an ka edhe një sure të veçantë me emrin "El-Kadr".

Ato shpjeguan kuptimet e kësaj Nate dhe adhurimit në të, që sikurse përmendet edhe në Kur'anin Famëlartë: "Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj".

Teologët e nderuara, përmes argumenteve nga Kur'anit dhe Tradita Profetike, shpjeguan dhe përcollën për teleshikuesit mirësitë e Natës së Kadrit dhe çfarë duhet të bëjë një besimtar me rastin e kësaj Nate të Begatë.

Nata e Kadrit është nata e 27 e muajit Ramazan dhe këtë vit i bie të jetë, ditën e xhuma, më 31 maj 2019.

## HATMEJA SHERIFE, BEKIM DHE MIRËSI PËR BESIMTARËT



**D**itën e xhuma, pas namazit të iqindisë, me praninë e shumë besimtarëve dhe besimtarëve, u zhvillua ceremonia e mbylljes së Hatmes Sherife në xhaminë e Parrucës.

Leximi i plotë i Kur'anit Famëlartë, apo siç njihet ndryshe Hatmeja Sherife, tashmë është bërë traditë e përvitshme gjatë çdo muaji të Ramazani. Imamë të Myftinisë Shkodër, hafizlerë mysafirë nga Turqia, si dhe shumë besimtarë dhe besimtare mbledhen çdo ditë pas namazit të iqindisë dhe lexojmë çdo ditë nga një xhyz nga Kur'anit Famëlartë.

Kjo traditë e bukur e leximit të plotë të Kur'anit përfundon me ceremoninë e mbylljes së Hatmes Sherife, në vigjilje të Natës së Kadrit.

Ditën e sotme, pasi u krye falja e

namazit të iqindisë, filloi programi me fjalën e hapjes nga teologu Arben Halluni, i cili falënderoi të gjithë ata, që morën pjesë në këtë Hatme, imamë, teologë, dy hafizlerë e ardhur nga Turqia enkas për muajin e Ramazanit, z. Fahri Furat dhe Muhamed Nurullah Kurkan, si dhe besimtarët e pranishëm.

Më pas, në emër të Myftinisë mbajti fjalën e rastit, teologu Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së "Dy Vajzave", i cili pasi falënderoi të pranishmit dhe dy hafizlerë nga Turqia, foli mbi rëndësinë e leximit të Kur'anit Famëlartë dhe lidhjen e fortë që duhet të ketë myslimani me Librin e All-llahut.

Lutja e Hatmes Sherife u drejtua nga H. Fahri Ruat në gjuhën arabe dhe nga teologu Lavdrim Hamja në gjuhën shqipe.

## NATA E KADRIT, XHAMITË E SHKODRËS MBUSHËN PLOT ME BESIMTARË



**N**ata e Kadrit, që është e 27-ta e Muajit Ramazan, është nata më e mirë se një mijë muaj. Ashtu, si për çdo vit, edhe këtë Ramazan, Myftinia Shkodër organizoi ditën e xhuma, më 31 maj 2019 një program të larmishëm me rastin e kësaj Nate të Begatë, që në fakt nisi me namazin e iqindisë, ku u mbyll edhe Hatmeja e

plotë e leximit të Kur'anit Famëlartë dhe dua ja e saj.

Pastaj, në mbrëmje, pas faljes së farzit të jacisë, në xhaminë e Parrucës, që ishte mbushur plot me besimtarë, madje edhe deri jashtë oborrit, teologu Lavdrim Hamja mbajti një ders të veçantë rreth vlerave dhe mirësive të Natës së Kadrit.

## AMBASADORI I OSBE-SË NË TIRANË, VIZITON MYFTININË SHKODËR



**D**itën e enjte, pasdreke Ambasadori i OSBE në Tiranë, Bernd Borchardt bëri një vizitë në Myftininë Shkodër. Ambasadori Borchardt u prit nga teologu Lavdrim Hamja dhe teologu Arben Halluni.

Pasi i uruan mirëseardhjen ambasadorit, të dy teologut bënë një tablo të punës së Myftinisë Shkodër dhe aktiviteteve të saj në shërbim të përhapjes së mesazheve të paqes të Islamit dhe ruajtjes e përhapjes së harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare në Shkodër.

U diskutua për problematikat e ndryshme, që shqetësojnë komunitetet fetare dhe rolin që këto komunitete luajnë për ruajtjen e harmonisë, bashkëjetesës dhe përhapjes së mesazheve të shpresës për të ardhmen e Shqipërisë.







# Haxhi 2019



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË  
**ORGANIZON HAXHI 2019**

**3700 €**

## Në paketën e Haxhit përfshihen:

- Transporti ajror vajtje-ardhje.
- Transporti me autobus në Mekë dhe Medine.
- Akomodimi në hotele.
- Ushqimi, mëngjesi, dreka dhe darka (me përjashtim: Mina & Arafat).
- Kurbani, ihrami, ujë zemzemi, numra telefoni etj.
- Shoqërimi nga teologë dhe mjekë përgjatë ritualit.

## Dokumentet e nevojshme

- Pasaporta e vlefshme jo më pak se 1 vit. Ndërsa personat që nuk kanë nënshtetësi shqiptare, të jenë të shoqëruar me lejen e qëndrimit, me afat vlefshmërie jo më pak se 6 muaj.
- Fotografi pasaporte (2 copë).
- Çertifikatë që vërteton lidhjen e gjakut mes shoqëruesit dhe femrave që janë nën moshën 45 vjeçare.
- Vaksina kundër meningjitit, me afat jo më pak se 10 ditë dhe jo më shumë se tre vjet.

**REGJISTROHUNI PRANË KMSH-SË OSE PRANË  
MYFTINISË SË QYTETIT TUAJ DERI MË DATË 17 QERSHOR 2019**



zyraehaxhit



Rr. "George.W. Bush"  
Nr. 50, Tirana/Albania



www.kmsh.al  
haxhi@kmsh.al



+35542230492  
+355 69 26 15 933

Botues:  
**Myftinia Shkodër**  
Drejtimes:  
**Imam Muhamed Sytari**

Kryeredaktor:  
**Lavdrim Hamja**

Tel / Fax:  
**+355 (0) 224 2081**  
Nr. llogarie:  
**100054 UBA - Shkodër**

   
**MYFTINIASHKODER1990**  
udhaislame@myftinia-shkoder.org  
www.myftinia-shkoder.org